



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01- 21977/24
Kaçanik, 08.09.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IX (nëntë) e Komitetit për Komunitete, , mbajtur më 08.09.2025 (e hënë).
Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit , me fillim pune në ora 11:00. Të pranishëm në takim ishin anëtarët e Komitetit për Komunitete : Ekrem Livoreka – i pavarur, Lejla Muhaxheri –Çaka- PDK, Betim Shala-LDK dhe Arta Avdiu-LVV, ndërsa anëtari Arben Thaqi- OJQ ka munguar në takim.
Nga ekzekutivi i komunës, në mbledhje mori pjesë zyrtarja në QPS, Antigona Axhami-Baftiu.

Mbledhjen e kryesoi , Ekrem Livoreka, Kryesues i Komitetit për Komunitete.
Procesmbajtës, Arbnora Kuka, zyrtare komunale.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka : Ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete. Kuorum kemi për të mbajtur mbledhjen. Falënderoj zyrtaren, znj.Antigona Axhami-Baftiu për pjesëmarrje në takim pasi që pika e rendit të punës është për rastet sociale në Komunën e Kaçanikut. Në këtë mbledhje do të vazhdojmë me këtë :

REND PUNE

- 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VIII (tetë) e Komitetit për Komunitete;**
- 2. Rastet Sociale në Komunën e Kaçanikut; dhe**
- 3. Të ndryshme.**

Nëse keni diçka rreth rendit të punës , e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit askush dhe rendi i punës prej 3(tri) pikë u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.

- 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 8(tetë) e Komitetit për Komunitete**
Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit?

Nëse jo atëherë procesverbalin e qes në votim për miratim, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit?

Procesverbali i mbledhjes 8(tetë) e Komitetit për Komunitete u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete:

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VIII (tetë) të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, të datës 12.08.2025

2. Rastet Sociale në Komunën e Kaçanikut

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- Besoj që znj.Antigona na jep më shumë të dhëna rreth rasteve sociale dhe shërbimeve sociale. Ja japim fjalën.

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Ju përshëndes të gjithëve, jam zyrtare për shërbime sociale në QPS. Në QPS janë dy sektorë: sektori i Asistencës sociale dhe sektori i shërbimeve sociale .Në sektorin për shërbime sociale trajtohen rastet e dhunës në familje, adoptimet , kujdesi për fëmijët me nevoja të veçanta, braktisja e fëmijëve, delikuentet, fëmijët me sjellje asociale. Unë sqarime më shumë mund të jap te shërbime sociale pasi që i përkas atij sektori, ndërsa sa i përket asistencës sociale nuk jam shumë në ngjarje.

Prej muajit janar të këtij viti në Kaçanik, kemi 14 raste të dhunës në familje, 3 raste janë me urdhër mbrojtje, kemi pasur më shumë raste me urdhër mbrojtje por i kanë rregulluar marrëdhëniet dhe i është ndërprerë urdhër mbrojtja.

Te fëmijët me nevoja të veçanta që marrin ndihmë sociale 120€ në muaj, ato janë 67 raste dhe 5 raste i kemi që kanë aplikuar që dalin në komision në muajin shtator.

Nëse keni pyetje urdhëroni.

Znj.Lejla Muhaxheri – Çaka – Do të thotë edhe 5 raste të fëmijëve me nevoja të veçanta do të shtohen.

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Po ata presin të dalin para komisionit mjekësorë. Komisioni në Ferizaj vendos nëse i aprovon apo i refuzon kërkesat.

Znj.Arta Avdiu- Si mblidhet komisioni mjekësorë , e kanë të caktuar me muaj apo në bazë të rasteve?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Komisioni e ka të caktuar çdo 4 muaj , i cakton ministria përbërjen prej 4 mjekëve dhe nga zyra jonë një zyrtarë. Komisionet janë rajonale. Ne i njoftojmë palët se cilat dokumente duhet t'i kenë me vete dhe i njoftojmë kur mbahet komisioni, pastaj vlerësimin e bënë komisioni.

Znj.Arta Avdiu- Ju e cekët se janë 67 raste të fëmijëve me nevoja të veçanta. Në krahasim me vitin paraprak a është në rritje numri i fëmijëve me nevoja të veçanta apo ka rënie?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Fatkeqësisht numri i fëmijëve me nevoja të veçanta është në rritje. Të gjithë janë në moshën nën 18 vjet.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- Kam një pyetje te adoptimi i fëmijëve , a ka pasur raste dhe cilat kritere duhet të plotësohen për adoptim të fëmijëve?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Po kemi pasur 9 (nëntë) raste . Tre raste janë hequr. Njëri rast jetojnë jashtë shtetit dhe ka aplikuar për adoptim vendor. Familjet që jetojnë jashtë shtetit duhet të aplikojnë për adoptim ndërkombëtarë. Te ajo familje kemi qenë në vizitë dhe e kemi parë që jetojnë jashtë shtetit dhe e kemi njoftuar gjykatën. Dy raste i ka hequr ministria sepse nuk i plotëson kushtet. Tash ka ndryshuar rregullorja sepse më herët vlerësimin e kemi bërë ne , mirëpo tani me ndryshimin e rregullores vlerësimin e bënë ministria. Ne vetëm i njoftojmë për rregullimin e dokumentacionit dhe jemi si ndërmjetësues në mes të palës dhe ministrisë. Ka edhe familje që janë tërhequr vet nga aplikimi. Aktualisht i kemi 5(pesë) familje që presin për adoptim. Para dy muaj është adoptuar një fëmijë dhe është në procedurë të vlerësimit deri në adoptim përfundimtarë.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- Pas adoptimit a bëni vizita rasteve?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Neve na intereson gjendja ekonomike dhe gjendja psikike e fëmijës së adoptuar. Janë të gjitha dokumentacionet e mjekut , psikologut etj., vizitojmë familjen nëse i plotëson kushtet për adoptim dhe bëjmë vlerësimin. Pas adoptimit është periudha e vizitës deri në tre muaj dhe përcjellim nëse fëmija ka përkujdesje dhe pas tre muaj ne e njoftojmë gjykatën për gjendjen e fëmijës. Pas tre muajsh familja e regjistron fëmijën në emër të vet dhe nuk mund të shkojmë shumë në vizita sepse nëse shkon shpesh fëmija e kupton që është i adoptuar.

Znj.Arta Avdiu- Në rast se fëmija ka nevojë për rehabilitim , sepse ka raste kur marrin vesh që janë të adoptuar dhe bëhen të dhunshëm dhe kanë probleme prindërit që e kanë adoptuar, edhe pse e dërgon fëmijën në psikolog privat. Ju si qendër a ndërmerrni diçka nëse pala drejtohet tek ju?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Ne i këshillojmë, por kur e shohim që është në gjendje më të rëndë, i udhëzojmë te psikologu klinik, te qendra e shëndetit mendor në Ferizaj.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- Pas lajmërimit të rasteve të dhunës në familje, si trajtohen rastet? Kush i mbikëqyr?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Fillimisht lajmërohet policia në Kaçanik, pastaj policia na njofton neve dhe ne shkojmë në stacion të policisë varësisht se kur ndodh rasti. Ne merremi edhe me viktimën edhe të dyshuarin. Nëse nuk ka ku të shkoj viktimë, nëse nuk ka mbështetje, viktimën e dërgojmë në strehimore , derisa të bëhet një zgjidhje më afatgjatë. Por ka raste kur kanë përkrahje në familje dhe shkojnë tek prindërit ose këdo që kanë. Pastaj ne shkojmë bisedojmë ndërkohë me ta dhe i këshillojmë,

që sadopak të rregullohet raporti. Në rastet mes bashkëshortëve ka raste që janë bashkuar , por edhe që janë ndarë. Nëse ka dhunë të vazhdueshme psikike dhe fizike unë nuk i këshilloj të bashkohen, por i udhëzoj të shkojnë në gjykatë. I njoftoj se si duhet të veprojnë rreth fëmijëve.

Znj.Arta Avdiu- Sa i përket strehimit, në këto raste , ku përfundon ajo familje, nëse nuk do me shku në strehimore? Ju si qendër a ndërmerrni diçka?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Po ai duhet të shkoj diku. Ne e kemi obligim me dërgu në strehimore deri në 6 muaj. Dhe ka shumë raste që janë bashkuar sepse strehimorja nuk i plotëson kushtet dhe janë kthyer prap bashkë. Unë kam kërkuar që edhe te banesa sociale të lihen të lira 2 ose 3 banesa për këto raste, t'i bëhet zgjidhje përkohësisht, por nuk ka pasur mundësi.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- Unë kam qenë pjesë e komisionit për ndarjen e banesave edhe unë kam menduar të lihen të lira 2 ose 3 banesa, por kanë qenë 67 aplikues për banesa dhe ne t'i lëmë banesat e zbrazëta nuk kishte mundësi. Do të ishte mirë një banesë të bëhet vetëm për këto raste.

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Kemi pasur një rast në strehimore, ka qenë me fëmijë. Ajo donte të kthehej te bashkëshorti se nuk mund të qëndronte në strehimore, por ai ishte me urdhërmbrojtje dhe nuk mund të marrsha vendim të kthehet, por ajo insistojë. Pastaj në bashkëpunim me gjykatën kanë mbajtur seancë dhe u kthye prap te dhunuesi se nuk kemi pasur zgjidhje tjetër për viktimën. Ne në QPS nuk mund të bëjmë gjithçka, por shërbimi jonë është bashkëpunim me gjykatën dhe policinë.

Znj.Arta Avdiu- Vitin e kaluar z.Xhelal Gashi na ka informuar për pilot projektin e skemave sociale. Nëse ke mundësi me na dhënë informacion se si ka funksionuar ky pilot projekt. A është në funksion ende dhe a janë ndarë të kënaqur palët?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Ka funksionuar mirë. Zyrtarët kanë dal në teren për verifikim të aplikuesve ndërsa miratimi është bërë në ministri. Projekti ende është në funksion.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- A është zvogëluar numri i familjeve me asistencë sociale apo është rritur?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Nuk e di numrin e saktë, mirëpo me sa di numri ka rënë të numrit.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- A keni ndonjë pyetje tjetër?
A keni afat me qëndru në palestër apo keni bërë ndonjë zgjidhje?

Znj.Antigona Axhami –Baftiu- Nuk jam kompetent unë për këtë përgjigje.

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- Nëse nuk keni diçka tjetër lidhur me këtë pikë të rendit të punës , ne falënderojmë zyrtaren për pjesëmarrje në mbledhje dhe vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të punës.

3.Të ndryshme

Kryesues i Komitetit , Ekrem Livoreka- A keni diçka për diskutim pasi që sot është edhe mbledhja e fundit e këtij Komiteti.

Për diskutim nuk u paraqit askush , mbledhja përfundoi në ora 11:35.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

